

URDHËR
Nr. 1386, datë 18.12.2025

**PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN NR. 266, DATË 29.8.2011, “PËR MIRATIMIN
E RREGULLORES ‘PËR INDUSTRIALIZIMIN DHE TREGTIMIN E UJËRAVE
MINERALE NATYRORE’”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008, “Për ushqimin”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Fjalja hyrëse e pikës 7 të rregullores “Për industrializimin dhe tregtimin e ujërave minerale natyrale”, bashkëlidhur urdhrin nr. 266, datë 28.8.2011, riformulohet si më poshtë:

“7. Burimet e ujërave minerale natyrale mund të shfrytëzohen dhe ujërat e tyre ambalazhohen vetëm nëse janë të pajisur me leje administrative të lëshuar nga organet kompetente për administrimin dhe menaxhimin e burimeve ujore dhe plotësohen kushtet e mëposhtme:”.

2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

3. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Andis Salla